

VENDIM
Nr. 54, datë 29.1.2020

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1039, DATË 4.12.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS
DHE PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË
KËTË KËSHILL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1039, datë 4.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 4, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Përfaqësimi i organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës përcaktohet sipas kritereve të mëposhtme:

a) për organizatat e punëmarrësve (konfederata, federata, sindikata):

i. personalitet juridik, sipas legjislacionit në fuqi, prej më shumë se 2 (dy) vjetësh;

ii. pavarësi organizative e financiare;

iii. shtrirje territoriale në të paktën 50 (pesëdhjetë) % të qarqeve të vendit, përfshirë dhe qarkun e Tiranës;

iv. strukturë administrative për të përmbushur detyrimet ligjore të partneritetit social;

v. numri i përgjithshëm i anëtarëve në konfederatë të jetë jo më pak se 5 (pesë) % e numrit të përgjithshëm të punëmarrësve në shkallë vendi, por jo më pak se 20 000 (njëzet mijë) anëtarë; ndërsa për federatat dhe sindikatat, numri i përgjithshëm i anëtarëve në shkallë vendi të jetë jo më pak se 5 (pesë) % e numrit të punëmarrësve në degën/profesionin përkatës;

vi. numri i kontratave kolektive, si dhe numri i përgjithshëm i punëmarrësve të mbuluar me kontrata kolektive;

vii. anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të punëmarrësve.

b) Për organizatat e punëdhënësve:

i. personalitet juridik, sipas legjislacionit në fuqi, prej më shumë se 2 (dy) vjetësh;

ii. pavarësi organizative e financiare;

iii. shtrirje territoriale në të paktën 50 (pesëdhjetë) % të qarqeve të vendit, përfshirë dhe qarkun e Tiranës;

iv. strukturë administrative për të përmbushur detyrimet ligjore të partneritetit social;

v. numri i anëtarëve që punësojnë të jetë jo më pak se 5 (pesë) % e numrit të punëmarrësve në degën/profesionin përkatës;

vi. numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të anëtarësuar, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10 (dhjetë) % nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);

vii. anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të punëdhënësve.”.

2. Pas pikës 14, shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. Me përfundimin e mandatit 3-vjeçar (trevjeçar), sekretariati i Këshillit Kombëtar të Punës mbledh dokumentacionin e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve, që janë të interesuara të jenë pjesë e këtij këshilli, 3 (tre) muaj përpara se të përfundojë mandati. Dokumentacioni i depozituar përbëhet nga vendimi i gjykatës, një kopje e statutit, deklaratimet që kanë të bëjnë me numrin e anëtarëve në subjektet përkatëse, vërtetuar nga kuotizacioni ose vërtetimet noteriale, numri i kontratave kolektive të punës, shtrirja gjeografike e veprimtarisë, si

dhe anëtarësimi i tyre në organizatat ndërkombëtare. Një organizatë e punëmarrësve apo e punëdhënësve vlerësohet më e përfaqësuar nëse ka numrin më të madh të kontratave kolektive dhe numrin më të madh të anëtarëve, ndërsa një organizatë punëdhënësish vlerësohet nga numri i ndërmarrjeve, numri i punonjësve të punësuar në ndërmarrje dhe numri i degëve/profesioneve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe